

VENDIM
Nr. 196, datë 19.6.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 10, pikave 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1757/2 prot., datë 16.6.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1757 prot., datë 7.6.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a” dhe për pikën 2.4, gjerat “a”, “c” dhe “d”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- Germa “a”: Shoqëria duhet të përfshijë në objektin e saj dhe veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Germa “b”: Duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion mbështetës të financimit të veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike për të paktën 1 muaj.

- Germa “c”: Plani i biznesit i depozituar i referohet vetëm veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltai “Blue 1”, por referuar kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores shoqëria duhet të depozitojë në ERE planin e biznesit për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të bëjë me dije se kur do të jetë funksional sistemi SKADA dhe po ashtu nëse ky sistem mbulon dhe realizimin e procesit të faturimit të klientëve.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti